



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE DHE PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE DHE MONITORIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë. \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

**Raporti teknik**

**Objekti** : Shërbimi i Pastrimit Bashkia Shkoder Zona Perendimore  
**Burimi i financimit** : Buxheti i Bashkise miratuar me VKB Nr. 84 Prot. date 18.12.2025, i ndryshuar  
**Afati i realizimit** : 36 muaj  
**Fondi preventivuar** : **124,635,259.23** lekë me tvsh  
**Vendodhja** : **Zona Perëndimore, Bashkia Shkodër**

**Gjendja aktuale**

Aktualisht shërbimi i pastrimit në zonën Perëndimore realizohet ne 100% te territorit, me sipërmarrës privat me një kontratë 3- vjecare që përfundon me 28 Qeshor 2026. Shërbimi i pastrimit të zonës Perëndimore është realizuar në tre menyra: shërbimi në zonën 1 per gjitha NjA me konteniere publik, shërbimi i pastrimit për zonën e plazhit për 110 ditë sezoni dhe dere-me-dere për zonën 3, ku perfshihet Kompleksi Fishta. Zerat e shërbimit konsistojne ne:

- Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve me konteniere;
- Menaxhim dhe Mirembajtje kazanesh;
- Grumbullimi i mbetjeve me qese dere-me-dere;
- Dezinfektimi i pgm've;
- Fshirja Manuale;

**Objektivi**

Objektivi kryesor i Bashkisë Shkodër është ofrimi i një shërbimi sa më cilësor për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane në Zonën Perëndimore.

Sa i përket Zonës Perëndimore, përveç shërbimeve të parashikuara në kontratën aktuale, janë parashikuar të ofrohen shërbime shtesë në disa njësi administrative, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe rritjen e standardeve të mirëmbajtjes publike, veçanërisht gjatë periudhës së sezonit turistik.

Në këtë kuadër, në Njësinë Administrative Bërdicë, Njësinë Administrative Dajç, Njësinë Administrative Ana e Malit, si dhe në Njësinë Administrative Velipojë, shërbimi i evadimit të mbetjeve urbane do të kryhet me një frekuencë prej 3 (tre) herësh në javë për secilën njësi nga 2 herë që është aktualja, duke garantuar një mbulim të rregullt dhe efikas të territorit dhe shmangien e akumulimit të mbetjeve.

Sa i përket Njësisë Administrative Velipojë, duke marrë në konsideratë fluksin e shtuar të vizitorëve gjatë sezonit turistik, do të zbatohen masa të veçanta dhe më intensive shërbimi. Konkretisht, në zonën e Plazhit, evadimi i mbetjeve do të realizohet çdo ditë gjatë gjithë sezonit, me një frekuencë prej 2 (dy) herësh në ditë nga 1 herë që është aktualisht , në mënyrë që të sigurohet pastërtia dhe higjiena e vazhdueshme e kësaj zone me rëndësi të lartë turistike. Ndërkohë, në zonën e Rrjollit, evadimi do të kryhet gjithashtu çdo ditë gjatë sezonit, por me frekuencë 1 (një) herë në ditë nga 3 herë në javë që e ka kontrata aktuale , duke reflektuar nevojat specifike të kësaj zone.

Gjithashtu, për Njësinë Administrative Velipojë (Zona e Plazhit) do të angazhohen burime të dedikuara njerëzore për garantimin e cilësisë së shërbimeve. Gjatë sezonit turistik do të jetë e detyrueshme prezenca e punonjësve për mirëmbajtjen e PGM-ve, të cilët do të kujdesen për funksionimin dhe pastërtinë e infrastrukturës përkatëse. Paralelisht, do të angazhohen punonjës për mirëmbajtjen e tualeteve publike, me qëllim sigurimin e standardeve të nevojshme higjieno-sanitare

për përdoruesit. Po ashtu, do të angazhohen punonjës për fshirjen manuale të hapësirave publike, duke kontribuar në mbajtjen e një mjedisi të pastër dhe të rregullt.

Në funksion të përmirësimit të kushteve mjedisore dhe estetikës urbane, do të realizohet gjithashtu lagia periodike e rrugëve kryesore në këtë njësi administrative, si dhe larja e kontenierëve. Këto masa synojnë reduktimin e pluhurit, përmirësimin e higjienës dhe rritjen e cilësisë së përgjithshme të shërbimit ndaj komunitetit dhe vizitorëve.